



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale
Komisioneri

Nr. _____ Prot

Tiranë, më __/__/2010

UDHËRRËFYES
I MBROJTJES SË TË DHËNAVE PERSONALE
Për Subjektet e të dhënave

PËRMBAJTJA

Hyrje	“	1
I. Mbrojtja e të dhënave personale nga veprimet e marrësve		
<i>a. Përpunimi i të dhënave përveç atyre sensitive</i>		
Mbrojtja	“	5
Kriteret	“	6
Siguria	“	6
Konfidencialiteti	“	7
Të drejtat e subjekteve	“	7
<i>b. Përpunimi i të dhënave sensitive</i>		
Kriteret	“	15
Siguria	“	16
Konfidencialiteti	“	17
Të drejtat e subjektit	“	17
<i>c. Transferimi ndërkombëtar i të dhënave</i>		
Mbrojtja	“	17
Kriteret	“	18
Siguria	“	19
Konfidencialiteti	“	20
Të drejtat e subjektit	“	20
II. Mbrojtja e të dhënave personale nga Kontrollues të veçantë		
Statusi i kontrolluesit	“	21
Mbrojtja	“	21
Kriteret	“	22
Siguria	“	23
Konfidencialiteti	“	24
Të drejtat e subjektit	“	24
III. Mbrojtja e të dhënave kur veprimet kryhen me mjetet e kontrolluesit nga vetë subjektet		
Njohja me mjetet ligjore	“	25
Ndërgjegjësimi	“	25
IV. Çfarë mund të bëni kur shkelen të drejtat tuaja		
Mbrojtja	“	26

UDHËRRËFYESI

I MBROJTJES SË TË DHËNAVE PERSONALE

Për Subjektet e të dhënave

Ky material është udhërrëfyes në ndihmë të Subjekteve të të dhënave personale, si dhe punonjësve të Zyrës së Komisionerit, për të hyrë, njohur dhe zbatuar të drejtat e tyre, si dhe rregullat që duhet të zbatojnë Kontrolluesit dhe Përpunuesit, për mbrojtjen e të dhënave personale dhe privatësisë, të parashikuara në ligjin nr. 9887, datë 10.3.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” dhe në aktet e tjera ligjore e nënligjore.

Për mbrojtjen e të dhënave personale ekziston një legjislacion i gjerë vendas dhe ndërkombëtar, i cili duhet të jetë në bazën e punës të Kontrolluesve dhe Përpunuesve dhe punonjësve të zyrës së Komisionerit.

Akte ndërkombëtare;

- Deklarata Universale e të drejtave dhe lirive të njeriut.
- Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, amenduar nga Protokollin nr.11, hyrë në fuqi më 1 Nëntor 1998.
- Konventa e Këshillit të Evropës “Për mbrojtjen e individëve nga Përpunimi Automatik i të Dhënave Personale”, ratifikuar me Ligjin nr.9288, datë 7.10.2004.
- Direktivat 95/46/EC dhe 2002/58/EC të Këshillit Evropian dhe Parlamentit Evropian.
- Protokollin shtesë i Konventës së KE “Për Mbrojtjen e individëve nga Përpunimi Automatik i të Dhënave Personale, lidhur me autoritetet mbikëqyrëse dhe lëvizjen ndërkufitare të të dhënave personale”, ratifikuar me ligjin nr.9287, datë 7.10.2004.

E drejta për mbrojtjen e të dhënave është një e drejtë që vazhdimisht përparon, dhe është e njohur në Kushtetutën Evropiane.

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë

a) Në nenin 35 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë garantohet e drejta për respektimin e jetës private dhe familjare. Ky nen parashikon:

1. Askush nuk mund të detyrohet, përveçse kur e kërkon ligji, të bëjë publike të dhëna që lidhen me personin e tij.

2. Mbledhja, përdorimi dhe bërja publike e të dhënave rreth personit bëhet me pëlqimin e tij, me përjashtim të rasteve të parashikuara me ligj.

3. Kushdo ka të drejtë të njihet me të dhënat e mbledhura rreth tij, me përjashtim të rasteve të parashikuara me ligj.

4. Kushdo ka të drejtë të kërkojë ndreqjen ose fshirjen e të dhënave të pavërteta ose të paplota ose të mbledhura në kundërshtim me ligjin.

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe Ligji nr. 9887, datë 10.3.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” përfshin në privatësi një rreth të gjërë të dhënash personale.

Me të dhëna personale kuptojmë: Çdo gjë, e dhënë dhe informacion që lidhet me personin, me jetën e tij private, të drejtat, prona, mjedisi që lidhet me pronën, banesa e pjesët e saj, veprimtaria dhe interesat vetiake, e drejta e votës, shprehja e fjala, veshja, paraqitja e jashtme, fotografia, hobet, shijet, dhuntitë, cilësitë e veçanta, aftësitë, çështjet e brendshme të familjes, të dhënat sensitive(jeta e prekshme, shqisore, intime, e ngushtë, vemesa e brendshme e njeriut, origjina racore ose etnike, mendimet politike, anëtarësimi në sindikata, besimi fetar apo filozofik, dënimi penal, si dhe të dhëna për shëndetin dhe jetën seksuale), tiparet biologjike unike(vetitë, ngjyra e syve, flokëve, ngjyra e lëkurës, përmasat e format e pjesëve të trupit, zëri, ecja), të dhënat biometrike(gjurmët e gishttrinjëve, imazhe të retinës, gjeometria e fytyrës ose duarve, irisit), karakteristikat gjenetike, etj.

Sipas nenit 3 të ligjit “Për mbrojtjen e të dhënave personale” e dhënë personale është informacioni që mundëson identifikimin e një personi të caktuar. Pra në privatësi si element i të dhënave personale përfshihen edhe:

Emri, mbiemri, datëlindja, adresa postare ose e e-mailit, numri i telefonit, numri identifikues i taksave, numri i patentës, shenjat e gishtërinjëve, ADN-ja, fotografitë, numri i sigurimeve shoqerore, llogari bankare(të dhëna financiare) ...keto jane të gjitha të dhëna që identifikojë individët, qoftë direkt ose indirekt.

Praktikisht, për çdo shërbim që na ofrohet në jetën tonë të përditshme kërkon ofrimin e të dhënave personale.

Ne i japim të dhënat tona kur hapim një llogari bankare, regjistrohemi për një kurs gjuhe, regjistrohemi në një palestër, aplikojmë për të marrë pjesë në një konkurs, rezervojmë një fluturim apo hotel, bëjmë një takim me mjekun, kërkojmë për punë ... çdo herë që paguajmë me kartë krediti ose lundrojmë në Internet. Ne lëmë pas një mori gjurmësh të të dhënave në të gjitha këto aktivitete.

Mekanizmat e përdorur për të mbledhur dhe përpunuar të dhënat personale janë në zhvillim të vazhdueshëm.

Kjo do të thotë se zhvillimi dhe aplikimi i teknologjive të reja kanë sjellë lehtësi dhe shpejtësi më të madhe në shkëmbimin e të dhënave, dhe si pasojë ka shkaktuar një rritje të numrit të përpunimit të të dhënave që janë bërë çdo ditë. Megjithëse është e pamohueshme që këto teknologji kanë përshpejtuar përparimin në shoqëritë moderne dhe kanë rritur cilësinë e jetës për publikun në përgjithësi, duhet të ketë gjithashtu një ekuilibër mes modernizimit dhe garantimit të të drejtave të qytetarëve.

Ky kufi delikat mes të drejtës së qytetarëve për të ruajtur kontrollin mbi të dhënat e tyre personale dhe aplikimit të teknologjive të reja kompjuterike përbëhet nga konteksti në të cilin Ligj-bërësit kanë vendosur të drejtën themelore për mbrojtjen e të dhënave personale.

I. Mbrojtja e të dhënave personale nga veprimet e marrësve

a. Përpunimi i të dhënave të zakonshme

Detyrimet e Kontrolluesve për përpunimin e të dhënave

Sipas nenit 3/3 të ligjit “Kontrollues”, *pra personi përgjegjës*- është çdo person fizik ose juridik, autoritet publik, agjenci apo njësi tjetër, të cilët, vetëm apo në bashkëpunim me të tjerë, mbajnë, përpunojnë, administrojnë, arkivojnë dhe për këtë shkak kontrollojnë të dhëna personale (*çdo organ qendror dhe vartës të tij në qendër apo gjetkë, që ushtrojnë autoritetin më vehte, sipas ligjit, aktit nënligjor apo statutit, rregulloreve, kontratave etj.*).

1.Mbrojtja(neni 5)

Parimi i përgjithshëm

Përpunimi i ligjshëm i të dhënave personale bëhet duke respektuar dhe garantuar të drejtat dhe liritë themelore të njeriut dhe, në veçanti, të drejtën e ruajtjes së jetës private.

Mbrojtja e të dhënave personale bazohet:

- a) në përpunimin në mënyrë të ndershme, të drejtë dhe të ligjshme;
- b) në grumbullimin për qëllime specifike, të përcaktuara qartë, e legjitime dhe në përpunimin në përputhje me këto qëllime;
- c) të dhënat duhet të jenë të mjaftueshme, të lidhen me qëllimin e përpunimit dhe të mos e tejkalojnë këtë qëllim;

- d) në saktësinë nga ana faktike dhe, kur është e nevojshme, në kryerjen e përditësimit të çdo veprimi për të siguruar që të dhënat e pasakta e të parregullta të fshihen apo të ndryshohen;
- e) në mbajtjen në atë formë, që të lejojë identifikimin e subjekteve të të dhënave për një kohë, por jo më tepër sesa është e nevojshme për qëllimin, për të cilin ato janë grumbulluar ose përpunuar më tej.

2. Kriteret(neni 6)

Të dhënat personale përpunohen vetëm:

- a) nëse subjekti i të dhënave personale ka dhënë pëlqimin;
- b) për hartimin dhe përmbushjen e kontratave, në të cilat subjekti i të dhënave personale është palë;
- c) për të mbrojtur interesat jetikë të subjektit të të dhënave;
- d) për përmbushjen e një detyrimi ligjor të kontrolluesit;
- e) për kryerjen e një detyre ligjore me interes publik ose ushtrimin e një kompetence të kontrolluesit ose të një pale të tretë, së cilës i janë përhapur të dhënat;
- f) për ndjekjen e interesave legjitimë të kontrolluesit ose të një pale të tretë, së cilës i janë përhapur të dhënat, përveç kur këta interesa mbizotërojnë mbi interesat për mbrojtjen e të drejtave dhe të lirive themelore të subjektit të të dhënave.

3. Siguria(neni 27)

Kontrolluesi ose përpunuesi merr masa organizative dhe teknike të përshtatshme për të mbrojtur të dhënat personale nga shkatërrime të paligjshme, aksidentale, humbje aksidentale, për të mbrojtur aksesin ose përhapjen nga persona të paautorizuar, veçanërisht kur përpunimi i të dhënave bëhet në rrjet, si dhe nga çdo formë tjetër e paligjshme përpunimi.

Kontrolluesi merr këto masa të veçanta sigurie:

- a) përcakton funksionet ndërmjet njësive organizative dhe operatorëve për përdorimin e të dhënave;
- b) përdorimi i të dhënave bëhet me urdhër të njësive organizative ose të operatorëve të autorizuar;
- c) udhëzon operatorët, pa përjashtim, për detyrimet që kanë, në përputhje me këtë ligj dhe rregulloret e brendshme për mbrojtjen e të dhënave, përfshirë edhe rregulloret për sigurinë e të dhënave;

ç) ndalon hyrjen në mjediset e kontrolluesit ose të përpunuesit të të dhënave të personave të paautorizuar;

d) hyrja në të dhënat dhe programet bëhet vetëm nga personat e autorizuar, dh) ndalon hyrjen në mjetet e arkivimit dhe përdorimin e tyre nga persona të paautorizuar;

e) vënia në punë e pajisjeve të përpunimit të të dhënave bëhet vetëm me autorizim dhe çdo mjet sigurohet me masa parandaluese ndaj vënies së autorizuar në punë;

ë) regjistron dhe dokumenton modifikimet, korrigjimet, fshirjet, transmetimet, etj.

3.1 Të dhënat e dokumentuara nuk përdoren për qëllime të tjera, që nuk janë në përputhje me qëllimin e grumbullimit. Ndalohet njohja ose çdo përpunim i të dhënave të regjistruara në dosje për një qëllim të ndryshëm nga e drejta për të hedhur të dhëna. Përfshihet nga ky rregull rasti kur të dhënat përdoren për parandalimin ose ndjekjen e një veprë penale.

3.2 Dokumentacioni i të dhënave mbahet për aq kohë sa është i nevojshëm për qëllimin, për të cilin është grumbulluar.

3.3 Niveli i sigurisë duhet të jetë i përshtatshëm me natyrën e përpunimit të të dhënave personale. Rregulla të hollësishme për sigurimin e të dhënave përcaktohen me vendim nr.1, datë 4.03.2010 të Komisionerit.

3.4 Procedurat e administrimit të regjistrimit të të dhënave, të hedhjes së të dhënave, të përpunimit dhe nxjerrjes së tyre përcaktohen me vendimin nr.2, datë 10.03.2010 të Komisionerit.

4. Konfidencialiteti i të dhënave(neni 28)

Kontrolluesit, përpunuesit dhe personat, që vihen në dijeni me të dhënat e përpunuara, gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre, detyrohen të ruajnë konfidencialitetin dhe besueshmërinë edhe pas përfundimit të funksionit. Këto të dhëna nuk përhapen, përveç rasteve të parashikuara me ligj.

5.Zbatimi i të drejtave të subjekteve(nenet 12-17)

E drejta për tu informuar për mbledhjen e të dhënave(neni 18)

Kontrolluesi, kur mbledh të dhëna personale, duhet ta informojë subjektin e këtyre të dhënave. Në këtë informacion duhet të përcaktohen kategoritë e të dhënave personale, që do të përpunohen, qëllimi i përpunimit, emri dhe adresa e kontrolluesit dhe çdo informacion tjetër, i nevojshëm, për të garantuar përpunimin e drejtë të të dhënave personale. Ky informacion nuk jepet, nëse subjekti i të dhënave ka dijeni për të.

Të dhënat mund të mblidhen nëpërmjet transmetimit nga një përpunim tjetër, i kryer nga i njëjti kontrollues ose kontrollues të tjerë. Në këto raste, informacioni nuk do të jepet, kur përpunimi i të dhënave është parashikuar nga ligji, kur është e pamundur dhënia e informacionit, për shkak se nuk mund të gjendet subjekti i të dhënave, ose kur të dhënat përpunohen sipas pikës 1 të nenit 10 të këtij ligji.

E drejta për tu njohur me regjistrin e mbrojtjes së të dhënave (neni 26 e 31)

Komisioneri krijon një regjistër për dokumentimin e të gjitha njoftimeve dhe autorizimeve, që ai kryen në ushtrim të kompetencave të tij, në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale, i cili është i hapur për njohje për çdo person.

E drejta për akses

Kjo e drejtë është e parashikuar nga neni 12 i kreut IV të Ligjit Nr. 9887, datë 10.3.2010 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” dhe nënkupton që çdo person ka të drejtë të bëjë një kërkesë me shkrim ku të kërkojë informacion nga kontrolluesi:

- a) Nëse të dhënat e tij po i nënshtrohen përpunimit ose jo;
- b) Një përshkrim për të dhënat të cilat po përpunohen, qëllimin e përpunimit dhe nëse këto të dhëna do të shpërndahen ndonjë personi apo organizate apo jo;
- c) Një kopje të të dhënave në formë të kuptueshme;
- d) Burimin nga merren të dhënat e tij, nëse ky është i mundur të gjendet;

Informacioni i kërkuar nga personi, jepet në formën që është kur është bërë kështu, brenda 30 ditëve nga bërja e saj ose po brenda këtij afati kontrolluesi iu kthen përgjigje me shpjegimin e mosdhënies së informacionit.

Kuptimi i të drejtës për akses lidhet ngushtësisht me konceptin e të dhënave personale që do të thotë se ju mund të keni të drejta dhe akses vetëm për të dhënat tuaja dhe nuk mund të keni asnjë informacion lidhur me të dhënat e të tjerëve, edhe nëse këto lidhen ose veprojnë kundrejt jush ose keni interes për këto të dhëna, prandaj duhet kuptuar qartë koncepti i të dhënave personale dhe përmbajtja e tyre.

E drejta për akses ju jep të drejtë të shikoni edhe dokumentet në të cilat këto të dhëna mbahen dhe përpunohen në përputhje me parimet kushtetuese të lirisë së shprehjes dhe informacionit, lirisë së shtypit dhe sekretit profesional, por i nënshtrohen edhe disa kufizimeve për raste dhe të dhëna të caktuara. Këto kufizime vendosen nëse e drejta për akses çënon interesat e sigurisë kombëtare, politikës së jashtme, interesat ekonomikë dhe financiarë jashtë shtetit, parandalimin dhe ndjekjen penale si edhe në rastet kur të dhënat janë përpunuar për qëllime shkencore e statistikore pa u përdorur për të marrë masa apo vendime për një individ.

Në rast se e drejta për akses mohohet me justifikimet e mësipërme atëhere keni të drejtë t'i kërkonti Komisionerit të kontrollojë nëse justifikimi për përjashtimin e pretenduar ekziston. Në këtë rast Komisioneri ju informon për masat e marra.

Të dhënat që ju merrni në informacion duhet të jenë të kuptueshme për vetë ju, sepse mund të ketë raste që është e pamundur të kuptohet përmbatja e informacionit, p.sh një rast i tillë mund të jetë kur informacioni mbi të dhënat e kërkuara është i koduar ose kur ju nuk keni njohuri të mjaftueshme të gjuhës shqipe. Në këto raste është mirë që t'iu ofrohet nga kontrolluesi një informacion i deshifruar ose i përkthyer.

Kërkesa për akses në të dhëna mund të bëhet edhe nga një palë e tretë e cila ju përfaqëson në kushtet e të drejtës civile, por në këto raste kontrolluesi kërkon prokurën e përfaqësimit.

E drejta për të kërkuar korrigjimin ose fshirjen

Të dhënat personale duhet të jenë të sakta, të jenë të vërtëta e të merren me mjete të ligjshme. Ky është një nga parimet kryesore të përpunimit të të dhënave personale. Në rast se këto të dhëna janë jo të sakta atëherë juve në cilësinë e subjektit të të dhënave ju lind e drejta të kërkonti ndreqjen e tyre. Neni 13 I Ligjit Nr. 9887, datë 10.3.2010 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” përcakton se;

“1. Cdo subjekt i të dhënave ka te drejte te kerkoje korrigjimin ose fshirjen e të dhënave, kur vihet në dijeni se të dhënat rreth tij nuk janë të rregullta, të vërtëta, të pOlota ose janë përpunuar dhe mbledhur në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji.

2. Kontrolluesi, brenda 30 ditëve nga data e marrjes së kërkesës së subjektit të të dhënave, duhet ta informojë atë për përpunimin e ligjshëm të të dhënave, kryerjen ose moskryerjen e korrigjimit apo fshirjes.

3. Kur kontrolluesi nuk bën korrigjimin ose fshirjen e të dhënave të kërkuara prej tij, subjekti I të dhënave ka të drejtë të ankohet te Komisioneri.”

Ky nen nënkupton që çdo individ i cili mendon se të dhënat e tij janë të pasakta, janë të pavërtëta, janë të parregullta ose janë përpunuar në kundërshtim me Ligjit Nr. 9887, datë 10.3.2010 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” mund t'i drejtohet kontrolluesit dhe t'i kërkojë korrigjimin ose fshirjen e tyre. Pas këtij veprimi, i mbetet në dorë kontrolluesit të vendosë nëse individ i ka të drejtë në kërkesën e tij apo jo. Nëse kontrolluesi bie dakort me kërkesën e individit, atëherë ai bën korrigjimin ose fshirjen e të dhënave. Në këtë rast korrigjuesi njofton për këtë korrigjim ose fshirje të gjithë personat të cilëve ia ka përhapur këto të dhëna si dhe vetë individin subjekt i të dhënave personale. Nëse kontrolluesi nuk bie dakort me kërkesën e individit dhe nuk e bën korrigjimin ose fshirjen e të dhënave, atëherë subjektit i lind e drejta të ankohet në Zyrën e Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Me vënien në lëvizje nga kjo kërkesë, Komisioneri ka të drejtë të nisë një hetim lidhur me këtë çështje. Nëse ai konstaton se kërkesat e tuaja janë të drejta, atëherë ai urdhëron kontrolluesin që të bëjë korrigjimin ose fshirjen e të dhënave. Moskorrigjimi i të dhënave sipas urdhërit të Komisionerit e ngarkon kontrolluesin me përgjegjësi administrative.

Shembull

Nëse ju regjistrohni në një institucion arsimor ose lidhni marrëdhënie pune me një institucion punëdhënës (qoftë ky shtetëror apo privat) dhe shikoni që në regjistrim emri juaj, mbiemri, mosha, atësia, amësia, etj, janë të pasakta, ose të pavërteta, atëherë keni të drejtë t'i kërkonti institucionit (i cili në këtë rast është kontrollues) që t'I korrigjojë ose t'I fshijë ato. Nëse institucioni me shkrim refuzon kërkesën tuaj të bëjë korrigjimin ose fshirjen, atëherë ju keni të drejtë t'i drejtoheni Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Me marrjen e kërkesës suaj Komisioneri nis një hetim për këtë çështje. Nëse nga hetimi del se ju keni të drejtë, atëherë Komisioneri e urdhëron institucionin arsimor ose punëdhënësin të bëjë korrigjimin ose fshirjen, në të kundërt institucioni do të ngarkohet me përgjegjësi administrative për moszbatim të urdhërimeve të Komisionerit.

Vendimmarrja automatike

Vendimmarrja automatike është parashikuar ***në nenin 14 të Kreut IV të Ligjit Nr. 9887***, datë 10.3.2010 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”:

“1. Çdo person ka të drejtë të mos jetë subjekt i vendimeve, të cilat shkaktajnë efekte ligjore për të ose ndikojnë në mënyrë të rëndësishme tek ai dhe kur vendimi është bazuar vetëm në përpunimin automatik të të dhënave, që synojnë të vlerësojnë disa aspekte personale, që lidhen me të, veçanërisht, efektivitetin në punë, besueshmërinë ose sjelljen.

2. Një person mund të jetë subjekt i një vendimi të marrë, sipas pikës 1 të këtij neni, kur merren masa për të mbrojtur interesat e tij të ligjshëm, veçanërisht duke përfshirë në vendim këndvështrimet e tij.”

Me vendimmarje automatike kuptojmë çdo vendim lidhur me të dhënat personale të subjektit, i marrë vetëm nga mjete automatike, pa ndërhyrjen e njeriut. Ai kryhet p.sh në rastet kur kompjuterat programohen për të vlerësuar informacionin për individë që kërkojnë një shërbim apo trajtim të veçantë (p.sh një kredi) përkundrejt kritereve të përcaktuara, dhe vendimi nëse këta individë mund ta përfitojnë këtë shërbim apo përfitim varet krejtësisht nga rezultati i gjeneruar nga ky vlerësim automatik.

Neni i mësipërm nënkupton që çdo individ ka të drejtë të mos jetë subjekt i vendimeve automatike të cilat shkaktajnë efekte ligjore tek ai. Kjo e drejtë lidhet me plotësimin e dy kushteve kryesore:

1. Vendimi të jetë marrë vetëm duke përdorur të dhënat personale në mënyrë automatike.

Shembull

Një punëtor ferme i cili paguhet në bazë të rendimentit, produktivitetit të tij në punë, që monitorohet automatikisht, matet me mjete automatike. Vendimi se sa do të paguhet ky punëtor në bazë të punës që ka bërë merret automatikisht, duke iu referuar të dhënave të tij të mbledhura për produktivitetin e tij.

Pra, ky vendim merret duke përdorur të dhënat e mbledhura për punëtorin, pa ndërhyrjen e njeriut.

Megjithatë ka raste kur disa vendime që shpesh quhen si automatike, merren me ndërhyrjen e njeriut.

Shembull

Një punonjës i një institucioni është paralajmëruar për ardhjen me vonesë në punë. Ky vendim është marrë sepse sistemi orëmatës automatik i institucionit ka nxjerre ne dukje faktin se punonjësi ka ardhur me vonesë në punë disa herë. Megjithëse vendimi është bazuar në të dhëna të mbledhura automatikisht, ai është marrë nga menaxheri i sistemit, duke vëzhguar të dhënat, prandaj ai nuk është një vendim automatik.

2. Kushti i dytë është që vendimi të shkaktojë një efekt të rëndësishëm tek subjekti, pra të ketë një domethënie të rëndësishme.

Kjo nënkupton që vendimarrja automatike të sjellë efekte të konsiderueshme në jetën e subjektit, që kanë të bëjnë me aspekte të tij personale, profesionale, ekonomike, etj. Vendimi i marrë në shembullin më lart për punëtorin e fermës ka një ndikim të rëndësishëm tek ai, sepse lidhet me pagesën që do të marrë për punën e bërë.

Pra, kjo e drejtë nuk mund të ushtrohet në rastet kur vendimi nuk shkakton efekte që ndikojnë në mënyrë të rëndësishme tek subjekti i të dhënave, ose ka një efekt të pakonsiderueshëm.

Shembull

Një person plotëson një “pyetësor personaliteti” online në internet. Ai i përgjigjet pyetjeve lidhur me veten në website, i cili i merr të dhënat, i përpunon dhe i jep personit përgjigjen për profilin e personalitetit të tij. Të dhënat nuk ruhen dhe profili nuk i dërgohet njeriu tjetër. Në këtë rast vendimi automatik i marrë lidhur me profiling e personalitetit të personit nuk ka një efekt të rëndësishëm për të.

Neni i mësipërm parashikon se ka edhe raste kur e drejta për të mos iu nënshtruar vendimarrjes automatike nuk ushtrohet edhe kur kjo vendimarrje ka efekt të rëndësishëm për subjektin e të

dhënave personale. Këto kufizime i referohen rasteve kur vendimi realizohet për të mbrojtur interesat e tij të ligjshëm, veçanërisht duke përfshirë në vendim këndvështrimet e tij.

E drejta e subjektit të të dhënave për të kundërshtuar

Në ligj nuk parashikohet mënyra e bërjes së kërkesës për të kundërshtuar, por do të ishte e mira që kjo kërkesë të bëhej me shkrim nga ana juaj dhe të paraqiste saktë se çfarë i kërkohet kontrolluesit. Në një kërkesë të tillë ju duhet të paraqitni:

- Kundërshtimin për përpunimin e të dhënave;
- Faktin që ky përpunim po ju shkakton dëm të konsiderueshëm ose shqetësim (stres) të madh;
- Duhet të sqaroni arsyet pse ky përpunim po ju shkakton këtë dëm.

Këtë të drejtë ju nuk mund ta ushtroni nëse:

- Keni dhënë pëlqimin për përpunimin;
 - Për të zbatuar një kontratë ku jeni palë dhe keni nënshkruar;
 - Keni kërkuar që të kryhet një veprim në mënyrë që të hyni në marrëdhënie kontraktore.
- Përpunimi është i nevojshëm për zbatimin e një detyrimi ligjor të kontrolluesit;
- Përpunimi është i nevojshëm për mbrojtjen e interesave tuaja jetike.

Shembull

Një kompani telefonie e lëvizshme merr një kërkesë nga një klient për të fshirë të dhënat e tij nga database i saj. Kjo kërkesë duhet të trajtohet si kundërshtim për përpunim. Klienti shjeron se nga përdorimi i të dhënave të tij për referenca për kredi i është shkaktuar atij një dëm i konsiderueshëm duke çuar në refuzimin e kartës së kreditit. Kompania nuk është dakort me këtë kërkesë, sepse përdorimi i të dhënave për referencat e kreditit është i nevojshëm për zbatimin e kontratës së cilës klienti ka firmosur, prandaj e drejta për të kundërshtuar përpunimin nuk mund të ushtrohet.

Të drejtën për të kundërshtuar përpunimin, ju mund ta përdorni vetëm për të dhënat tuaja dhe jo për të dhënat që i përkasin personave të tjerë.

Në ligj nuk përcaktohet as çfarë do të quajmë dëm të konsiderueshëm ose shqetësim (stres), gjithsesi për funksion të kësaj dispozite ligjore do të quajmë dëm të konsiderueshëm humbjet financiare ose dëmtimet fizike dhe shqetësim ose dëm jomaterial gjendjet e stresit, ndryshimet emocionale, frikën, mërzinë, presionin psikologjik, etj.

Në rast se kontrolluesi të cilit ju i drejtoheni me kërkesë është dakort, atëherë ai duhet të ndërmarrë veprimet e nevojshme si dhe t'ju informojë nëse është ndërmarrë ndonjë veprim deri në atë moment apo jo.

Nëse kontrolluesi nuk e përmbush kërkesën tuaj, atëherë ju keni të drejtë të ankoheni në Zyrën e Komisionerit. Komisioneri ndërmerr një hetim dhe nëse e shikon të arsyeshme e detyron kontrolluesin të përmbushë kërkesat tuaja.

Në pikën 2 të nenit 15 parashikohet :

“2. Subjekti i të dhënave ka të drejtë t'i kërkojë kontrolluesit të mos fillojë ose, nëse përpunimi ka filluar, të ndalojë përpunimin e të dhënave personale, që lidhen me të, për qëllime të tregtimit të drejtpërdrejtë.”

Tregtimi i drejtpërdrejtë ka të bëjë me ata kontrollues që i dërgojnë individëve informacione në lidhje me produktet të cilat kontrolluesit e tyre i prodhojnë apo për shërbime të cilat ata i ofrojnë, me shpresën që individët do t'i blejnë. Këto informacione mund të dërgohen me postë, faks, email (spam) ose me anë të telefonit.

Pika e mësipërme i jep subjektit të të dhënave të drejtën që t'i kërkojë kontrolluesit që të mos përpunojë të dhënat e tij ose nëse ka filluar të ndërpritet përpunimi, për qëllime të tregtimit të drejtpërdrejtë të materialeve reklamuese ose të të ashtuqujturit “marketing direkt”. Kjo nënkupton që nëse ju keni dhënë të dhënat tuaja personale tek një kontrollues, ai nuk ka të drejtë t'i përdorë ato për qëllime të biznesit (përveç kur ju keni dhënë vetë pëlqimin).

Për shembull, nëse ju jeni regjistruar si klient në një supermarket dhe keni dhënë të dhënat tuaja me qëllim që të merrni kartën e klientit, ju keni të drejtë t'i kërkonit përfaqesuesve të tij të mos i përdorin këto të dhëna për qëllime marketingu, pa dhënë ju pëlqimin. Kjo nënkupton se nëse ju keni dhënë numrin tuaj të telefonit, supermarketi nuk ka të drejtë t'ju sjellë mesazhe për oferta të ndryshme. Nëse e bën këtë gjë, ju keni të drejtë ta ndaloni.

Shembull tjetër do të ishte: Nëse i jepni një intervistë një gazetareje dhe imazhi juaj përdoret për një reklamë pa lejen tuaj.

Këto mënyra të përdorimit të të dhënave për qëllime të tregtimit quhen përdorim për qëllime të marketingut direkt.

E drejta për t'u ankuar

E drejta për t'u ankuar është parashikuar në nenin 16 të Ligjit Nr. 9887, datë 10.3.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”:

1. Çdo person, që pretendon se i janë shkelur të drejtat, liritë dhe interesat e ligjshëm për të dhënat personale, ka të drejtë të ankohet ose të njoftojë komisionerin dhe të kërkojë ndërhyrjen e

tij për vënien në vend të së drejtës së shkelur. Pas këtij ankimi, në përputhje me Kodin e Procedurës Civile, subjekti i të dhënave mund të ankohet në gjykatë.

2. Në rast se subjekti i të dhënave ka bërë ankim, kontrolluesi nuk ka të drejtë të ndryshojë të dhënat personale deri në dhënien e vendimit përfundimtar.

Ky nen i jep të drejtë çdo personi të cilit i janë shkelur të drejtat, liritë dhe interesat e ligjshëm që të ankohet për këtë fakt. Në rast se me të drejtat e tij është abuzuar nga ana e kontrolluesit, atëherë ju keni të drejtë të kërkonti ndërhyrjen e Komisionerit për të vënë në vend të drejtën e shkelur. Ankimi në Zyrën e Komisionerit është një hallkë e ndërmjetme pa të cilën nuk mund të vazhdohet të procedohet më tej në Gjykatë në rast se shkelja vazhdon. Ankimi pranë Zyrës së Komisionerit ka efekt pezullues për kontrolluesin, sepse në momentin që ju bëni ankimin, kontrolluesi nuk ka të drejtë të ndryshojë të dhënat personale deri në dhënien e vendimit përfundimtar.

Kompensimi i dëmit

Kompensimi i dëmit parashikohet në nenin 17 të Ligjit Nr. 9887, datë 10.3.2010 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”:

“Çdo person, të cilit i është shkaktuar një dëm, si rezultat i përpunimit të paligjshëm të të dhënave personale, ka të drejtë t’i kërkojë kompensim kontrolluesit për dëmin e shkaktuar.”

Ky nen imponon kontrolluesin të jetë i kujdesshëm gjatë mbledhjes dhe përpunimit të të dhënave të individëve, t’i përpunojë ato në mënyrë të ligjshme, të saktë, të ndershme, në përputhje me qëllimin e përpunimit dhe të mos e kalojë këtë qëllim, në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr. 9887, datë 10.3.2010 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”. Nëse ai shkel këto dispozita duke ju shkaktuar një dëm si rezultat i përpunimit të paligjshëm, atëherë ju (individ, subjekt i të dhënave personale) keni të drejtë të kërkonti kompensimin e dëmit. Kompensimi kërkohet me një kërkesë drejtuar Gjykatës sipas Kodit të Procedurës Civile, pasi ju t’i jeni drejtuar Komisionerit dhe ky i fundit të ketë dalë me një vendim, lidhur me shkeljen e të drejtave të personit gjatë përpunimit të të dhënave personale.

Në ligj nuk përcaktohet kuptimi i dëmit, por ne do të konsiderojmë të tillë çdo veprim që i ka sjellë individit humbje të vlerave monetare ose financiare si dhe çdo dëm moral që ka pësuar individ.

Një shembull i pësimit të dëmit financiar mund të jetë rasti kur në uebsaidin e një banke ndodh një gabim dhe publikohen numrat e llogarive të klientëve dhe një klient pëson humbje në llogarinë e tij të kursimeve për shkak të këtij publikimi.

Një shembull i pësimit të dëmit jo material mund të jetë rasti kur emri i një personi, publikohet gabimisht në listën e personave të cilët nuk kanë shlyer detyrimet financiare të një institucioni.

Në këtë rast këtij personi i dëmtohet emri i tij, ndaj ai pëson një dëm jo material pikërisht sepse kontrolluesi i institucionit ka përpunuar gabim të dhënat e tij.

Masa e kompensimit nuk është e përcaktuar në ligj, por ajo mund të vendoset në bazë të aktit të ekspertimit specifik dhe është Gjykata ajo që vendos masën e dëmit.

Të drejtat e parashikuara për ju (subjekt i të dhënave) kanë një rëndësi të veçantë në procesin e sensibilizimit të opinionit dhe të njohjes me të dhënat personale, pasi ato janë të drejta që na takojnë të gjithëve dhe që mund t'i ushtrojmë të gjithë. Për realizimin e tyre mbështet dhe ndihmon Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, i cili është gjithmonë në shërbim të publikut dhe mirëpret ankesat tuaja.

E drejta për të kërkuar procedimin penal

Çdo person, i cili është cënuar nga veprimet e paligjshme të kontrolluesve apo personave fizik, të cilat përbëjnë vepër penale, kanë të drejtë të kërkojnë në policinë gjyqësore ose te prokurori procedimin e autorit dhe shpërblimin e dëmit të shkaktuar, sipas neneve 58 dhe 283 të Kodit Procedurës Penale.

b. Përpunimi i të dhënave sensitive

Detyrimet e kontrolluesve për zbatimin e Rregullave të përpunimit.

1. Kriteret

Përpunimi i të dhënave sensitive bëhet vetëm nëse:

- a) subjekti i të dhënave ka dhënë pëlqimin, që mund të revokohet në çdo çast dhe e bën të paligjshëm përpunimin e mëtejshëm të të dhënave;
- b) është në interesin jetik të subjektit të të dhënave ose të një personi tjetër dhe subjekti i të dhënave është fizikisht ose mendërisht i paaftë për të dhënë pëlqimin e vet;
- c) autorizohet nga autoriteti përgjegjës për një interes të rëndësishëm publik;
- ç) lidhet me të dhëna, që janë bërë haptazi publike nga subjekti i të dhënave ose është i nevojshëm për ushtrimin apo mbrojtjen e një të drejte ligjore;
- d) të dhënat përpunohen për kërkime shkencore ose statistikore;
- dh) të dhënat kërkohen për qëllime të mjekësisë parandaluese, diagnostikimit mjekësor, sigurimit të kujdesit shëndetësor, kurimit, menaxhimit të shërbimeve të kujdesit shëndetësor dhe përdorimi i tyre kryhet nga personeli mjekësor ose persona të tjerë, që kanë detyrimin për ruajtjen e fshehtësisë;

e) të dhënat përpunohen nga organizatat jofitimprurëse politike, filozofike, fetare ose sindikaliste, për qëllime të veprimtarisë të tyre të ligjshme, vetëm për anëtarët, sponsorizuesit ose personat e tjerë, që kanë lidhje me veprimtarinë e tyre. Këto të dhëna nuk u bëhen të ditura një pale të tretë, pa pëlqimin e subjektit të të dhënave, përveç kur parashikohet ndryshe në ligj;

ë) përpunimi është i nevojshëm për përmbushjen e detyrimit ligjor dhe të të drejtave specifike të kontrolluesit në fushën e punësimit, në përputhje me Kodin e Punës.

Përpunimi i të dhënave sensitive, në rrethana të tjera nga ato të përcaktuara në pikën 2 të këtij neni, rregullohet me vendim të Këshillit të Ministrave, vetëm për qëllime të interesave të rëndësishëm publikë, nën masa të përshtatshme mbrojtëse.

2. Siguria

2.1 Kontrolluesi ose përpunuesi merr masa organizative dhe teknike të përshtatshme për të mbrojtur të dhënat personale nga shkatërrime të paligjshme, aksidentale, humbje aksidentale, për të mbrojtur aksesin ose përhapjen nga persona të paautorizuar, veçanërisht kur përpunimi i të dhënave bëhet në rrjet, si dhe nga çdo formë tjetër e paligjshme përpunimi.

Kontrolluesi merr këto masa të veçanta sigurie:

- a) përcakton funksionet ndërmjet njësive organizative dhe operatorëve për përdorimin e të dhënave;
- b) përdorimi i të dhënave bëhet me urdhër të njësive organizative ose të operatorëve të autorizuar;
- c) udhëzon operatorët, pa përjashtim, për detyrimet që kanë, në përputhje me këtë ligj dhe rregulloret e brendshme për mbrojtjen e të dhënave, përfshirë edhe rregulloret për sigurinë e të dhënave;
- ç) ndalon hyrjen në mjediset e kontrolluesit ose të përpunuesit të të dhënave të personave të paautorizuar;
- d) hyrja në të dhënat dhe programet bëhet vetëm nga personat e autorizuar, dh) ndalon hyrjen në mjetet e arkivimit dhe përdorimin e tyre nga persona të paautorizuar;
- e) vënia në punë e pajisjeve të përpunimit të të dhënave bëhet vetëm me autorizim dhe çdo mjet sigurohet me masa parandaluese ndaj vënies së autorizuar në punë;
- ë) regjistron dhe dokumenton modifikimet, korrigjimet, fshirjet, transmetimet etj.

2.2 Të dhënat e dokumentuara nuk përdoren për qëllime të tjera, që nuk janë në përputhje me qëllimin e grumbullimit. Ndalohet njohja ose çdo përpunim i të dhënave të regjistruara në dosje për një qëllim të ndryshëm nga e drejta për të hedhur të dhëna. Përfshihet nga ky rregull rasti kur të dhënat përdoren për parandalimin ose ndjekjen e një veprë penale.

2.3 Dokumentacioni i të dhënave mbahet për aq kohë sa është i nevojshëm për qëllimin, për të cilin është grumbulluar.

2.4 Niveli i sigurisë duhet të jetë i përshtatshëm me natyrën e përpunimit të të dhënave personale. Rregulla të hollësishme për sigurimin e të dhënave përcaktohen me vendim të komisionerit.

2.5 Procedurat e administrimit të regjistrimit të të dhënave, të hedhjes së të dhënave, të përpunimit dhe nxjerrjes së tyre janë përcaktuar në vendimin nr..., datë... të Komisionerit.

3. Konfidencialiteti i të dhënave

Kontrolluesit, përpunuesit dhe personat, që vihen në dijeni me të dhënat e përpunuara, gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre, detyrohen të ruajnë konfidencialitetin dhe besueshmërinë edhe pas përfundimit të funksionit. Këto të dhëna nuk përhapen, përveç rasteve të parashikuara me ligj.

4. Zbatimi i të drejtave të subjekteve(nenet 12-17)

- E drejta për tu informuar për mbledhjen e të dhënave
- E drejta për tu njohur me regjistrin e mbrojtjes së të dhënave
- E drejta për akses
- E drejta për të kërkuar korrigjimin ose fshirjen
- Vendimmarrja automatike
E drejta e subjektit të të dhënave për të kundërshtuar
- E drejta për t'u ankuar
- Kompensimi i dëmit

c. Transferimi ndërkombëtar i të dhënave

Detyrimet e Kontrolluesve për zbatimin e rregullave të përpunimit.

1.Mbrojtja

Mbrojtja e të dhënave personale bazohet:

- a) në përpunimin në mënyrë të ndershme, të drejtë dhe të ligjshme;
- b) në grumbullimin për qëllime specifike, të përcaktuara qartë, e legjitime dhe në përpunimin në përputhje me këto qëllime;
- c) të dhënat duhet të jenë të mjaftueshme, të lidhen me qëllimin e përpunimit dhe të mos e tejkalojnë këtë qëllim;
- d) në saktësinë nga ana faktike dhe, kur është e nevojshme, përditësimin e kryerjen e çdo veprimi për të siguruar që të dhënat e pasakta e të parregullta të fshihen apo të ndryshohen;
- e) në mbajtjen në atë formë, që të lejojë identifikimin e subjekteve të të dhënave për një kohë, por jo më tepër sesa është e nevojshme për qëllimin, për të cilin ato janë grumbulluar ose përpunuar më tej.

2. Kriteret

2.1 Transferimi ndërkombëtar i të dhënave personale kryhet, me marrës, nga shtete me një nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave personale. Niveli i mbrojtjes së të dhënave personale për një shtet përcaktohet duke vlerësuar të gjitha rrethanat lidhur me përpunimin, natyrën, qëllimin dhe kohëzgjatjen e tij, shtetin e origjinës dhe destinacionin përfundimtar, aktet ligjore dhe standardet e sigurisë në fuqi në shtetin marrës. Shtetet, që kanë nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

2.2 Transferimi ndërkombëtar i të dhënave personale me një shtet, që nuk ka nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave personale mund të bëhet nëse:

- a) autorizohet nga akte ndërkombëtare, të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë dhe që janë të zbatueshme në mënyrë të drejtpërdrejtë;
- b) subjekti i të dhënave ka dhënë pëlqimin për transferim ndërkombëtar;
- c) përbën detyrim për përmbushjen e një kontrate të përfunduar ndërmjet kontrolluesit dhe subjektit të të dhënave ose një pale të tretë, në interesin e subjektit të të dhënave;
- ç) është detyrim ligjor i kontrolluesit;
- d) është i nevojshëm për mbrojtjen e interesave jetësorë të subjektit të të dhënave;
- dh) është i nevojshëm apo përbën një kërkesë ligjore për një interes të rëndësishëm publik ose për ushtrimin dhe mbrojtjen e një të drejte ligjore;

e) është bërë nga një regjistër, i cili është i hapur për këshillime dhe siguron informacion për publikun në përgjithësi.

2.3 Shkëmbimi i të dhënave personale me përfaqësitë diplomatike të qeverive të huaja ose institucionet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë vlerësohet transferim ndërkombëtar.

Autorizimi

Transferimi ndërkombëtar i të dhënave personale me një shtet, që nuk ka nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave, në raste të tjera nga ato të parashikuara në nenin 8 të këtij ligji, bëhet me autorizim të Komisionerit.

Komisioneri, pasi bën vlerësimin, mund të japë autorizimin për transferimin e të dhënave personale në shtetin marrës, duke përcaktuar kushte dhe detyrime.

Komisioneri nxjerr udhëzime për lejimin e disa kategorive të transferimeve ndërkombëtare të të dhënave personale në një shtet që nuk ka nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave personale. Në këto raste, kontrolluesi përjashtohet nga kërkesa për autorizim.

Kontrolluesi, përpara transferimit të të dhënave, bën kërkesë për autorizim te Komisioneri. Në kërkesë kontrolluesi duhet të garantojë respektimin e interesave për ruajtjen e sekretit të subjektit të të dhënave jashtë Republikës së Shqipërisë.

3.Siguria

3.1 Kontrolluesi ose përpunuesi merr masa organizative dhe teknike të përshtatshme për të mbrojtur të dhënat personale nga shkatërrime të paligjshme, aksidentale, humbje aksidentale, për të mbrojtur aksesin ose përhapjen nga persona të paautorizuar, veçanërisht kur përpunimi i të dhënave bëhet në rrjet, si dhe nga çdo formë tjetër e paligjshme përpunimi.

3.2 Kontrolluesi merr këto masa të veçanta sigurie:

- a) përcakton funksionet ndërmjet njësive organizative dhe operatorëve për përdorimin e të dhënave;
- b) përdorimi i të dhënave bëhet me urdhër të njësive organizative ose të operatorëve të autorizuar;
- c) udhëzon operatorët, pa përjashtim, për detyrimet që kanë, në përputhje me këtë ligj dhe

rregulloret e brendshme për mbrojtjen e të dhënave, përfshirë edhe rregulloret për sigurinë e të dhënave;

ç) ndalon hyrjen në mjediset e kontrolluesit ose të përpunuesit të të dhënave të personave të paautorizuar;

d) hyrja në të dhënat dhe programet bëhet vetëm nga personat e autorizuar, dh) ndalon hyrjen në mjetet e arkivimit dhe përdorimin e tyre nga persona të paautorizuar;

e) vënia në punë e pajisjeve të përpunimit të të dhënave bëhet vetëm me autorizim dhe çdo mjet sigurohet me masa parandaluese ndaj vënies së autorizuar në punë;

ë) regjistron dhe dokumenton modifikimet, korrigjimet, fshirjet, transmetimet etj.

3.3 Të dhënat e dokumentuara nuk përdoren për qëllime të tjera, që nuk janë në përputhje me qëllimin e grumbullimit. Ndalohet njohja ose çdo përpunim i të dhënave të regjistruara në dosje për një qëllim të ndryshëm nga e drejta për të hedhur të dhëna. Përfshihet nga ky rregull rasti kur të dhënat përdoren për parandalimin ose ndjekjen e një veprë penale.

3.4 Dokumentacioni i të dhënave mbahet për aq kohë sa është i nevojshëm për qëllimin, për të cilin është grumbulluar.

3.5 Niveli i sigurisë duhet të jetë i përshtatshëm me natyrën e përpunimit të të dhënave personale. Rregulla të hollësishme për sigurimin e të dhënave përcaktohen me vendim të Komisionerit.

3.6 Procedurat e administrimit të regjistrimit të të dhënave, të hedhjes së të dhënave, të përpunimit dhe nxjerrjes së tyre përcaktohen në vendimin e mësipërm të Komisionerit.

4. Konfidencialiteti i të dhënave

Kontrolluesit, përpunuesit dhe personat, që vihen në dijeni me të dhënat e përpunuara, gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre, detyrohen të ruajnë konfidencialitetin dhe besueshmërinë edhe pas përfundimit të funksionit. Këto të dhëna nuk përhapen, përveç rasteve të parashikuara me ligj.

5. Zbatimi i të drejtave të subjekteve (nenet 12-17)

- E drejta për tu informuar për mbledhjen e të dhënave
- E drejta për tu njohur me regjistrin e mbrojtjes së të dhënave

- E drejta për akses
- E drejta për të kërkuar korrigjimin ose fshirjen
- Vendimmarrja automatike
- E drejta e subjektit të të dhënave për të kundërshtuar
- E drejta për t'u ankuar
- Kompensimi i dëmit
- E drejta për të kërkuar procedimin penal (neni 58 e 283 të K.Pr.P)

II. Mbrojtja e të dhënave personale nga veprimet e marrësve të veçantë

Kontrollues të veçantë mund të jenë:

- Policia e Shtetit
- Policia Gjyqësore
- Prokuroria
- SHISH
- Gjykatat
- Organ i Sigurisë Kombëtare
- ILDKP, etj.

Detyrimet e kontrolluesve për zbatimin e rregullave të përpunimit

1. Statusi i kontrolluesit të veçantë

Përpunimi i të dhënave personale, të përcaktuara në kuadër të veprimtarive të parandalimit dhe ndjekjes penale, për kryerjen e një vepre penale kundër rendit publik dhe të veprave të tjera në fushën e të drejtës penale, si dhe në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë kombëtare, kryhet nga autoritetet zyrtare të përcaktuara në ligj (neni 6 pika 2).

2. Mbrojtja (neni 5)

Parim i përgjithshëm

Përpunimi i ligjshëm i të dhënave personale bëhet duke respektuar dhe garantuar të drejtat dhe liritë themelore të njeriut dhe, në veçanti, të drejtën e ruajtjes së jetës private (neni 2).

Mbrojtja e të dhënave personale bazohet:

- a) në përpunimin në mënyrë të ndershme, të drejtë dhe të ligjshme;

- b) në grumbullimin për qëllime specifike, të përcaktuara qartë, e legjitime dhe në përpunimin në përputhje me këto qëllime;
- c) të dhënat duhet të jenë të mjaftueshme, të lidhen me qëllimin e përpunimit dhe të mos e tejkalojnë këtë qëllim;
- d) në saktësinë nga ana faktike dhe, kur është e nevojshme, të bëhet përditësimi e kryerja e çdo veprimi për të siguruar që të dhënat e pasakta e të parregullta të fshihen apo të ndryshohen;
- e) në mbajtjen në atë formë, që të lejojë identifikimin e subjekteve të të dhënave për një kohë, por jo më tepër sesa është e nevojshme për qëllimin, për të cilin ato janë grumbulluar ose përpunuar më tej.

3. Kriteret

Ligjet specifike të këtyre kontrolluesve të veçantë:

- Ligji “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar.
- Kodi i Procedurës Penale.
- Ligji “Për Krijimin e Qendrës së Përpunimit të të Dhënave ” .
- Ligji “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”.
- Ligji “Për organizimin dhe funksionimin e SHISH”.

4. Ligji nr.9887, datë 10.03.2009 “Per mbrojtjen e të dhënave personale” në nenet 8 e 9 parashikon këto kriteret:

Transferimi ndërkombëtar i të dhënave personale kryhet, me marrës, nga shtete me një nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave personale. Niveli i mbrojtjes së të dhënave personale për një shtet përcaktohet duke vlerësuar të gjitha rrethanat lidhur me përpunimin, natyrën, qëllimin dhe kohëzgjatjen e tij, shtetin e origjinës dhe destinacionin përfundimtar, aktet ligjore dhe standardet e sigurisë në fuqi në shtetin marrës. Shtetet, që kanë nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Transferimi ndërkombëtar i të dhënave personale me një shtet, që nuk ka nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave personale mund të bëhet nëse:

- a) autorizohet nga akte ndërkombëtare, të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë dhe që janë të zbatueshme në mënyrë të drejtpërdrejtë;
- b) subjekti i të dhënave ka dhënë pëlqimin për transferim ndërkombëtar;
- c) përbën detyrim për përmbushjen e një kontrate të përfunduar ndërmjet kontrolluesit dhe subjektit të të dhënave ose një pale të tretë, në interesin e subjektit të të dhënave;

ç) është detyrim ligjor i kontrolluesit;

d) është i nevojshëm për mbrojtjen e interesave jetësorë të subjektit të të dhënave;

dh) është i nevojshëm apo përbën një kërkesë ligjore për një interes të rëndësishëm publik ose për ushtrimin dhe mbrojtjen e një të drejte ligjore;

e) është bërë nga një regjistër, i cili është i hapur për këshillime dhe siguron informacion për publikun në përgjithësi.

Shkëmbimi i të dhënave personale me përfaqësitë diplomatike të qeverive të huaja ose institucionet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë vlerësohet transferim ndërkombëtar.

5. Autorizimi

Transferimi ndërkombëtar i të dhënave personale me një shtet, që nuk ka nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave, në raste të tjera nga ato të parashikuara në nenin 8 të këtij ligji, bëhet me autorizim të Komisionerit.

Komisioneri, pasi bën vlerësimin, mund të japë autorizimin për transferimin e të dhënave personale në shtetin marrës, duke përcaktuar kushte dhe detyrime.

Komisioneri nxjerr udhëzime për lejimin e disa kategorive të transferimeve ndërkombëtare të të dhënave personale në një shtet që nuk ka nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave personale. Në këto raste, kontrolluesi përjashtohet nga kërkesa për autorizim.

Kontrolluesi, përpara transferimit të të dhënave, bën kërkesë për autorizim te komisioneri. Në kërkesë kontrolluesi duhet të garantojë respektimin e interesave për ruajtjen e sekretit të subjektit të të dhënave jashtë Republikës së Shqipërisë.

6. Siguria(neni 27)

Referojuni kapitullit I.

7. Konfidencialiteti i të dhënave

Kontrolluesit, përpunuesit dhe personat, që vihen në dijeni me të dhënat e përpunuara, gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre, detyrohen të ruajnë konfidencialitetin dhe besueshmërinë edhe pas përfundimit të funksionit. Këto të dhëna nuk përhapen, përveç rasteve të parashikuara me ligj.

8. Zbatimin e të drejtave të subjekteve(nenet 12-17)

Për shkak të statusit të veçantë të këtyre institucioneve, nuk zbatohen të drejtat e parashikuara në nenet 18 dhe 12 dhe 15 të ligjit “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.

E drejta për të kërkuar korrigjimin ose fshirjen(neni 13 e 19)

Çdo subjekt i të dhënave ka të drejtë të kërkojë korrigjimin ose fshirjen e të dhënave, kur vihet në dijeni se të dhënat rreth tij nuk janë të rregullta, të vërteta, të plota ose janë përpunuar dhe mbledhur në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji.

Kontrolluesi, brenda 30 ditëve nga data e marrjes së kërkesës së subjektit të të dhënave, duhet ta informojë atë për përpunimin e ligjshëm të të dhënave, kryerjen ose moskryerjen e korrigjimit apo të fshirjes.

Kur kontrolluesi nuk bën korrigjimin ose fshirjen e të dhënave të kërkuara prej tij, subjekti i të dhënave ka të drejtë të ankohet te Komisioneri.

Vendimmarrja automatike(neni 14)

Çdo person ka të drejtë të mos jetë subjekt i vendimeve, të cilat shkaktojnë efekte ligjore për të ose ndikojnë në mënyrë të rëndësishme tek ai dhe kur vendimi është bazuar vetëm në përpunimin automatik të të dhënave, që synojnë të vlerësojnë disa aspekte personale, që lidhen me të, veçanërisht, efektivitetin në punë, besueshmërinë ose sjelljen.

Një person mund të jetë subjekt i një vendimi të marrë, sipas pikës 1 të këtij neni, kur merren masa për të mbrojtur interesat e tij të ligjshëm, veçanërisht duke përfshirë në vendim këndvështrimet e tij.

E drejta për t'u ankuar(neni 16)

Çdo person, që pretendon se i janë shkelur të drejtat, liritë dhe interesat e ligjshëm për të dhënat personale, ka të drejtë të ankohet ose të njoftojë Komisionerin dhe të kërkojë ndërhyrjen e tij për

vënien në vend të së drejtës së shkelur. Pas këtij ankimi, në përputhje me Kodin e Procedurës Civile, subjekti i të dhënave mund të ankohet në gjykatë.

Në rast se subjekti i të dhënave ka bërë ankim, kontrolluesi nuk ka të drejtë të ndryshojë të dhënat personale deri në dhënien e vendimit përfundimtar.

Kompensimi i dëmit(neni 17)

Çdo person, të cilit i është shkaktuar një dëm, si rezultat i përpunimit të paligjshëm të të dhënave personale, ka të drejtë t'i kërkojë kompensim kontrolluesit për dëmin e shkaktuar.

E drejta për të kërkuar procedimin penal

Çdo person, i cili është cenuar nga veprimet e paligjshme të kontrolluesve apo personave fizik, të cilat përbëjnë vepër penale, ka të drejtë të kërkojë në policinë gjyqësore ose te prokurori procedimin e autorit dhe shpërblimin e dëmit të shkaktuar, sipas neneve 58 dhe 283 të Kodit të Procedurës Penale.

III. Mbrojtja e të dhënave kur veprimet kryhen me mjetet e kontrolluesit nga vetë subjektet (rrjetet sociale, telefonia, etj.)

Njohja me mjetet ligjore për realizimin e të drejtave të përfaqësuesit të rrjeteve sociale

Artikuj në median e shkruar

Zbatim i Rregullave të vetë rrjeteve sociale

Njohje me Paketa të këshillave të Komisionerit

Njohje me Udhëzime, vendime, etj, të Komisionerit

Fletë palosje

Ndjekje të Webside e Zyrës së Komisionerit

Ndjekje e marrje pjesë në Aktivitete të zyrës së Komisionerit

Ndërgjegjësim për parandalimin e rreziqeve nga përdorimi i rrjeteve sociale

Aktivitete të zyrës së Komisionerit

Pasqyrim në Webside të akteve të Komisionerit

Njohje me të drejtën e ankimit të Komisionerit kur ju cenohen të drejtat

Njohja me rregullat e mbrojtjes së vetë rrjeteve sociale

Njohja me të drejtën e ankimit në organin e prokurorisë kur veprimet përbëjnë vepër penale

Komisioneri për realizimin e të drejtave të subjekteve të të dhënave personale ka një sërë kompetencash si:

- Pritje të ankesave;
- Zgjidhje dhe rivendosje të të drejtave, nëpërmjet ndërhyrjes te kontrolluesit publikë dhe privatë;
- Aplikim të gjobave ndaj kontrolluesve;
- Dhënie të rekomandimeve.

IV. C'farë mund të bëni kur shkelen të drejtat tuaja ?

Nëse ju dyshoni se të drejtat tuaja për mbrojtjen e të dhënave janë shkelur, së pari duhet të përpiqeni të përcaktoni identitetin e kontrolluesit. Për ta bërë këtë, ju mund të ushtroni të drejtën tuaj për t'u njohur me Regjistrin e Njoftimeve të kryera nga kontrolluesit privatë e publikë pranë Zyrës së Komisionerit, si dhe të drejtat tuaja për akses, korrigjim, fshirje dhe / ose kundërshtim, sipas rastit.

Nëse kjo procedurë nuk ka sjellë rezultate të kënaqshme, ju mund ti drejtoheni institucionit të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Çdo person, që pretendon se i janë shkelur të drejtat, liritë dhe interesat e ligjshëm për të dhënat personale, ka të drejtë të ankohet ose të njoftojë Komisionerin dhe të kërkojë ndërhyrjen e tij për vënien në vend të së drejtës së shkelur. Pas këtij ankimi, në përputhje me Kodin e Procedurës Civile, subjekti i të dhënave mund të ankohet në gjykatë.

Kur ju të kontaktoni me zyrën e Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, ju duhet ta përshkruani problemin në detaje të mjaftueshme, duke përdorur formularët dhe format e parashikuara për këtë qëllim në faqen e internetit të Komisionerit të Mbrojtjes së të Dhënave, në www.idp.al.

Me bindjen se ky udhërrëfyes do të shërbejë për mbrojtjen e të dhënave tuaja personale dhe privatësisë, do të kërkoja ta studioni, përvetësoni dhe të kërkonit zbatimin e kërkesave të tij tek çdo kontrollues e përpunues.

KOMISIONERI

Flora Çabej(POGAÇE)

Hartuan: A.Gjoleka &A.Shala

Bashkëpunuan: Elka Dafa; Fjorda Shqarri

Tirana më 26.07.2010